



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 132/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Therandë, paraqitur kundër Nismës për Kosovën dega në Therandë, për shkak të vendosjes së posterëve, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Therandë kështu që Nismës për Kosovën, dega Therandë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 600 (gjashtëqind) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 04.06.2014, në ora 10:30 aktivistët e LVV-së, kanë vërejtur se në rrugën “Brigada 123” në qytetin e Therandës ishin vendosur posterët e kandidatëve për Kuvendin e Kosovës Haxhi Shala dhe Shqipe Gashi nga radhët e Nismës për Kosovën në stacionin e autobusëve objekt që është në pronësi publike. Për këtë, në kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/201,3 vendosja e posterëve në objekte publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Sipas parashtruesit të ankesës Nisma për Kosovën me vendosjen e posterit në shenjë të komunikacionit që është objektë publik ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar një fotografi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të tij, e informoi Nismën për Kosovën, me datën 05.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.06.2014 deri në ora 10:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si prova të cilat gjinden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatve për Kuvendin e Kosovës Haxhi Shala dhe Shqipe Gashi të Nismës për Kosovën janë vendosur në stacionin e autobusëve që është në pronësi

publike në Komunën e Therandës, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. që ndalon vendosjen e posterëve në objekte publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe

PZAP-i, mori parasysh rrethanat lehtësuese ngase subjekti në fjalë, pas marrjes së Kërkesës për dhënie të Përgjigjes në ankesë për të Ndërmarr Masa Përmirësuese, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar banerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti NISMA për Kosovën ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se *"Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore"*.

Duke marrë parasysh se subjekti NISMA për Kosovën pas pranimit të Kërkesës për Përgjigje në ankesë dhe Urdhrit për të Ndërmarr Masat Përmirësuese nga PZAP-i, subjekti në fjalë menjëherë ka larguar posterat e theksuar në ankesë, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në përgjigje të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 132/2014 më datën 06.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*